

Tetor 2018

# EVN ZHURNAL

Gazeta për partnerët  
dhe bashkëpunëtorët

ENERGJIA QË JU NEVOJITET!



**Të nderuar partnerë dhe bashkëpunëtorë,**

Në edicionin e saj të ri, EVN Zhurnal synon të jetë edhe njëherë mjete juaj informativ i integruar mbi çështjet e energjisë për biznesin tuaj. Në këtë numër të katërt të revistës Zhurnal, ju çojmë në një udhëtim nëpër të gjitha zhvillimet e fundit në tregun e energjisë, të cilat ndikojnë në mënyrën se si e udhëhiqni biznesin. Konsiderojmë se është përgjegjësia jonë t'ju informojmë për evenimentet më të gjera në mjedisin tuaj të biznesit, si dhe t'ju prezantojmë masat operative relevante.

Evenimenti më i rëndësishëm në tremujorin e fundit është Ligji i ri për Energjinë, i cili në thelb vë në fuqi shumë prej ndryshimeve të shumëpritura, me të cilat tregu i energjisë në Maqedoni është një hap më afër BE-së. Ligji i ri për Energji do të hapë plotësisht tregun e energjisë elektrike, do të sjellë shumë përfitime për bizneset, si dhe integrim më të madh të burimeve të ripërtëritshme të energjisë në konsumin personal dhe në miksin total të energjisë. Bizneset mund t'ju përmbushin plotësisht nevojat e tyre për energji elektrike në bazë të vendimeve të informuara që ofrojnë mundësi për kursim dhe rritje.

Në këtë numër i ndihmojmë lexuesit tanë që të kuptojnë më mirë mënyrën se si bëhen ofertat e energjisë elektrike dhe arsyet për vlefshmërinë e tyre të kufizuar. Për të arritur këtë qëllim, i hulumtojmë gjerësisht faktorët që ndikojnë në çmimin e energjisë elektrike në tregun e hapur.

Këtë rast e shfrytëzojmë që të informojmë klientët potencialë të interesuar rreth shërbimeve të reja që janë në dispozicion, veçanërisht për shkak të rregullores së re. Gjithashtu, bisedojmë edhe me një udhëheqës biznesi dhe tregojmë metoda që përdoren për të krijuar kursime më të mëdha të energjisë elektrike nëpërmjet punës në tregun e hapur. Në fund, shkurtimisht japim një pasqyrë të lajmeve të tjera nga tremujori i mëparshëm.

Shpresojmë se përmbajtjet në këtë botim do të jenë një kontribut i jonë i vogël në suksesin e biznesit tuaj!

**Me respekt,**  
Ekipi redaktues i EVN Zhurnal

**Përmbajtja 10/18**

**03** EVN Maqedoni Elektrofnizimi - Takime rajonale me bashkësinë e biznesit

**04** Ligji i ri për energjinë elektrike hap rrugën drejt mundësive të reja

**05** Mbrojtja e klientëve dhe ruajtja e stabilitetit financiar - shtylla kryesore e EVN Maqedoni Elektrofnizimi

**06** Sistem fotovoltaik - zgjidhje për energji të ripërtrishme të energjisë për biznesin tuaj

**07** Intervistë me z. Ajdovan Ademoski, president i Odës Ekonomike të Maqedoni-Turqi (MATTO)

**08** "Dita e Tesllës" – Përmbajtje të reja në Qendrën ekspozuese në "Matkë"



# EVN Maqedoni Elektrofurnizimi - Takime rajonale me bashkësinë e biznesit

Më tepër se 1,000 kompani të cilat në vitin 2017 kishin një konsum vjetor prej më shumë se 100 MWh u kualifikuan për të marrë pjesë në tregun e hapur të energjisë nga 1.7.2018. Që të mund të bëjnë një zgjedhje të informuar për nevojat e tyre për furnizim me energji elektrike, këto kompani kishin nevojë për këshilla dhe mbështetje profesionale. EVN Maqedoni Elektrofurnizimi, si lider në treg dhe partner i dëshmuar i ekonomisë maqedonase, e njohu nevojën për mënyrë më të detajuar, të drejtpërdrejtë për informimin dhe edukimin e klientëve potencialë në lidhje me përfitimet dhe sfidat që dalin nga tregu i lirë.

Nga ky aspekt, në prill EVN Maqedoni Elektrofurnizimi organizoi 17 takimeve rajonale me kompani të kualifikuara në të gjithë territorin e Republikës së Maqedonisë. Menaxherët për konsumatorët kryesorë dhe të biznesit i informuan detajisht kompanitë mbi përparësitë që i sjell tregu i liberalizuar për bizneset, mundësitë për uljen e shpenzimeve të energjisë elektrike dhe hapat e ardhshëm të nevojshëm për të filluar furnizimin me energji elektrike në këtë treg. Takimet ishin relevante dhe të personalizuar për grupin e synuar, kurse pjesëmarrësve u janë ofruar informacione cilësore me rëndësi thelbësore për marrjen e vendimeve kyçe lidhur me furnizimin me energji elektrike.



Takimet u organizuan sipas parimit të tryezës së rumbullakët, ku përveç këshillave prej menaxherëve për përdoruesit kryesorë dhe të biznesit, klientët potencialë patën mundësinë të thonë pritjet e tyre dhe të mësojnë më

shumë për përfitimet e mundshme bazuar në përvojat e kaluara. Këto përvoja i treguan përfaqësuesit e kompanive që tashmë punojnë në tregun e hapur dhe të cilat kanë bashkëpunim të gjatë të suksesshëm me kompaninë tonë.



# Ligji i ri për energjinë elektrike hap rrugën drejt mundësive të reja

Hapet tërësisht tregu i energjisë elektrike dhe të gjithë konsumatorët kanë mundësi të përzgjedhin furnizues me energji elektrike, me të cilin do t'i negociojnë bashkarish kushtet për furnizim me energji elektrike dhe çmimin e energjisë elektrike.

Ligji i ri për energjinë elektrike, që hyri në fuqi në qershor të këtij viti, do të krijojë një sektor energjetik të qëndrueshëm, konkurrent dhe financiarisht stabil, të bazuar në parimet e mosdiskriminimit, objektivitetit dhe transparencës, dhe do të krijojë konkurrencë në prodhimin dhe furnizimin me energji elektrike.

Ligji gjithashtu duhet të mundësojë edhe mbrojtjen më të madhe të konsumatorëve, t'i zmadhojë kompetencat dhe të drejtat e Komisionit Rregullator për Energjetikë dhe Shërbimet e Ujit në Republikën e Maqedonisë, si dhe të emërojë një operator të pavarur të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike, me ndarjen e pronësisë nga ushtruesit e aktiviteteve të tjera në sektorin e energjisë siç janë furnizimi, prodhimi dhe tregtia e energjisë elektrike.

Me interes të madh për kompanitë është fakti se me ligjin e ri hapet plotësisht tregu i energjisë elektrike, me shumicë dhe pakicë dhe të gjithë konsumatorët, pavarësisht nga kategoria, kanë mundësinë të përzgjedhin furnizues me energji elektrike, me të cilin

do t'i negociojnë bashkarish kushtet për furnizim me energji elektrike dhe çmimin e energjisë elektrike.

Amvisritë dhe konsumatorët e vegjël, ku numri mesatar i të punësuarve në dy vitet e fundit të kontabilitetit është më i vogël se 50 dhe të ardhurat totale vjetore janë më pak se dy milionë euro, nuk do të jenë të detyruar të zgjedhin një furnizues në tregun e hapur. Nëse ata nuk zgjedhin një furnizues, ata do të furnizohen nëpërmjet të ashtuquajturit Furnizuesi universal me energji elektrike. Furnizuesi universal është i obliguar të furnizojë këta konsumatorë dhe në rast se furnizuesi i tyre i përzgjedhur ndërpret furnizimin me energji elektrike. E rëndësishme për sektorin e biznesit është se me ligjin e ri, të ashtuquajturit konsumatorët e mëdhenj marrin mbrojtje nëse mbeten pa furnizues me energji elektrike. Në afat prej 90 ditësh ata do të mund të furnizohen nga i ashtuquajturit furnizues i instancës së fundi dhe për këtë kohë duhet të gjejnë një furnizues të ri. Çmimet, afatet dhe mënyra e funksionimit e furnizuesit universal dhe furnizuesit

në momentin e fundit rregullohen nga Komisioni Rregullator për Energjetikën dhe për Shërbimet e Ujërave të Republikës së Maqedonisë.

Me ndryshimet në ligjin e ri, kujdesi i veçantë i kushtohet mbrojtjes së të drejtave dhe interesave të konsumatorëve. Furnizuesit me energji elektrike luajnë një rol të rëndësishëm në këtë fushë. Ata kujdesen për informimin në kohë të konsumatorëve për tema kyçe si për të drejtat për ndryshimin e furnizuesit, mënyrën e pagesës së faturave, mënyrën e zgjidhjes së ankesave të tyre, krijimin e qendrave të kontaktit etj.

Përveç kësaj, në funksion të sigurimit të ofertave konkurruese për konsumatorët, në tregun e organizuar të energjisë elektrike vendoset i a.q. Operatori i tregut të organizuar të energjisë elektrike. Ushtruesit e aktiviteteve energjetike, duke përfshirë edhe operatorin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike dhe operatorin e sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike, do të jenë në gjendje të blejnë

përkatësisht, të shesin energji elektrike për humbjet, duke optimizuar në këtë mënyrë portofolin e tyre dhe duke i zvogëluar kështu debalancat e mundshme.

Në brendësi të trendeve globale që parashikojnë një përdorim gjithnjë e më të madh të energjisë së ripërtëritshme për shkak të efektivitetit të kostos, si dhe përparësive ekologjike, janë futur edhe inovacionet në pjesën e shfrytëzimit të burimeve të ripërtëritshme të energjisë. Një risi pozitive është mundësia që konsumatorët të instalojnë burime të energjisë së ripërtëritshme për nevojat e tyre, kurse tepicën ta transferojnë në një rrjet shpërndarës që në pjesën e bizneseve do të kontribuojë në rritjen e kursimeve afatgjata. Pikërisht për këtë arsye, ndër të tjerat, në periudhën e ardhshme, pritet zmadhim në pjesëmarrjen e burimeve të ripërtëritshme të energjisë në konsumin përfundimtar, për çka një faktor i rëndësishëm është futja e tarifave premium, të cilat si mekanizëm mundësojnë integrimin e burimeve të ripërtëritshme të energjisë në të gjithë tregun e energjisë elektrike, është një faktor i rëndësishëm.

## VLEFSHMËRIA E OFERTËS PËR SHITJE TË ENERGISË ELEKTRIKE

# Mbrojtja e klientëve dhe ruajtja e stabilitetit financiar - shtylla kryesore e EVN Maqedoni Elektrofurnizimi

Një nga mjetet për minimizim e ekspozimit financiar nga çmimet e ndryshueshme të shitjes me shumicë të energjisë elektrike është dizajni i mirë i vlefshmërisë së ofertës për furnizim me energji elektrike që i jepet konsumatorit dhe komunikimi aktiv me konsumatorin në lidhje me pranimin eventual të ofertës.

Në funksionimin e tregut të hapur të energjisë elektrike, roli i furnizuesit është të blejë energji elektrike në tregun e energjisë elektrike me shumicë dhe të shesë në tregun e shitjes me pakicë tek konsumatorët, kështu që mund të thuhet se furnizuesit me energji elektrike mbajnë lidhjen midis tregut me shumicë dhe pakicë.

Prej furnizuesve me energji elektrike që veprojnë në një treg konkurrues të energjisë elektrike me një numër të mjaftueshëm pjesëmarrësish të tregut pritet të japin energji elektrike nga tregu i shitjes me shumicë në tregun me shitje me pakicë me çmime konkurruese, duke minimizuar ekspozimin e të dyja palëve të paqëndrueshmërisë së tregut me shumicë.

Një masë për minimizimin e ekspozimit financiar ndaj çmimeve të ndryshueshme të shitjes me shumicë të energjisë elektrike është përcaktimi korrekt i vlefshmërisë së ofertës për furnizim me energji elektrike të konsumatorit dhe komunikimi aktiv me konsumatorin në lidhje me pranimin e ofertës.

Më saktë, kur furnizuesi i jep konsumatorit një ofertë për furnizim me energji elektrike me një çmim fiks të vlefshëm për një javë, furnizuesi mbetet i ekspozuar ndaj luhatjeve të çmimeve të shitjes me shumicë deri në kohën kur klienti pranon ose refuzon ofertën ose më shumë në qoftë se klienti nuk reagon deri në fund të vlefshmërisë së ofertës.



Duke pasur parasysh faktin se çmimet e shitjes me shumicë të energjisë elektrike mund të rriten ose ulen ndjeshëm gjatë javës, këto ndryshime të çmimeve mund të ndikojnë lehtë në marzhën e furnizuesve deri në atë masë që mund të zhvlerësojnë tërësisht fitim e furnizuesit ose ta reduktojë kursimin te konsumatorët.

Në praktikë, për shkak se ata nuk janë në dijeni për kushtet dhe tendencat e tregut me shumicë, konsumatorët kërkojnë që ofertat për energji elektrike të kenë një afat më të gjatë të vlefshmërisë që lëviz nga 7 në 90 ditë, ndërsa në anën tjetër, oferta me një afat të shkurtër të vlefshmërisë nuk është tërheqëse për shkak të periudhës së shkurtër të vendimmarrjes. Dhënia e ofertave me afat më të gjatë të vlefshmërisë do të thotë që furnizuesi duhet të përfshijë rrezikun e lëvizjeve të pafavorshme në çmimet e shitjes me shumicë, duke rritur kështu çmimin përfundimtar që ua ofron konsumatorëve. Si një kompromis i përgjithshëm, shumica e furnizuesve i krijojnë ofertat me periudha të ndryshme të vlefshmërisë, ndërsa konsumatorët vlerësojnë ofertat dhe marrin vendime brenda periudhës së vlefshmërisë.

Kushtet e ndryshueshme të tregut me shumicë i nxisin furnizuesit e energjisë elektrike ta ndjekin tregun e paparashikueshëm dhe t'i shqyrtojnë me kujdes të veçantë rreziqet ndaj të cilave janë të ekspozuar nëpërmjet pjesëmarrjes në atë treg, veçanërisht ato që lidhen me paqëndrueshmërinë në çmimet e shitjes me shumicë. EVN Maqedoni Elektrofurnizimi e njeh rëndësinë e përmirësimit dhe mbrojtjes së lidhjes midis tregjeve me shumicë dhe pakicë të energjisë elektrike. Pikërisht për këtë arsye, imperativi ynë si një furnizues është të mbrojmë klientët tanë nga paqëndrueshmëria e çmimeve të shitjes me shumicë nëpërmjet çmimeve / produkteve të qëndrueshme, të parashikueshme dhe lehtësisht të kuptueshme të shitjes me pakicë, me periudha të vlefshmërisë të hartuara me kujdes, që na mbrojnë edhe neve si furnizues, por edhe konsumatorët, nga ekspozimi ndaj rrezikut financiar në tregun e energjisë elektrike. Ne i inkurajojmë konsumatorët që të veçojnë kohë për të vlerësuar ofertat dhe kushtet tona të marrëveshjes brenda periudhës së vlefshmërisë dhe të vendosin për ofertën që mbështet biznesin e tyre. Mbrojtja e klientëve tanë duke ruajtur stabilitetin financiar është dhe do të jetë shtylla kryesore e funksionimit të EVN Maqedoni Elektrofurnizimi si furnizues.



## SHËRBIM I RI I EVN-SË

# Sistem fotovoltaik - zgjidhje për energji të ripërtrishme të energjisë për biznesin tuaj

EVN-ja, si lider në tregun e shërbimeve të energjisë elektrike, i ndjek dhe i zbaton në mënyrë aktive trendet globale lidhur me energjinë e ripërtëritshme dhe investon në zhvillimin e teknologjive në këtë fushë. Deri tani kompania në Maqedoni ka investuar më shumë se 330 milionë euro në përmirësimin e infrastrukturës së përgjithshme të energjisë, duke përfshirë edhe rivitalizimin e prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e ripërtëritshme. Zhvillimi i mëtejshëm i energjisë së ripërtëritshme është një investim afatgjatë në mbrojtjen e mjedisit dhe në diversitetin e mundësive energjetike.

Dielli është një burim i pastër, i arritshëm dhe i rinovueshëm i energjisë. Duke pasur parasysh se përdorimi i teknologjive moderne për prodhimin e energjisë diellore sjell përfitime të shumfishta për konsumatorët dhe shtetin, EVN-ja në Maqedoni gjithashtu po investon në krijimin e këtij lloji të kapaciteteve prodhuese.

Menjëherë pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve të fundit në Ligjin për Energjetikën, i cili krijoi një mundësi për përdorim më të madh komercial të sistemeve fotovoltaike, EVN-ja e ofroi këtë lloj shërbimi për të gjithë konsumatorët e interesuar - bizneset dhe amvisëritë. Ekipi i ekspertëve të EVN-së ka zhvilluar opsione që përqendrohen tek përdoruesit dhe janë krijuar sipas nevojave të tyre, gjë që e bën energjinë diellore të ripërtëritshme në Maqedoni në dispozicion të çdo konsumatori të interesuar.



## Karakteristika dhe fitime nga shfrytëzimi i energjisë diellore

Energjia diellore shfrytëzohet nëpërmjet instalimit të sistemeve a.q. fotovoltaike ose pajisjet, të njohura si panele diellore si - fotovoltaikë. Panelet janë pjesa kryesore e infrastrukturës për prodhimin e energjisë diellore, e cila ndërvepron me instalimin elektrik të brendshëm të konsumatorët dhe me rrjetin shpërndarës elektrik. Prodhimi i energjisë varet nga vendosja e paneleve dhe kushtet e motit. Për të marrë efektin maksimal, është e domosdoshme që fotovoltaikët të jenë vendosur siç duhet dhe të ketë kushtet të përshtatshme

natyrore - qielli i pastër dhe rrezet e të drejtpërdrejta diellore. Por sistemet mund të funksionojnë pa problem edhe në mot me re dhe me dritë të përhapur.

Duke vendosur panele diellore, ju e ulni ndjeshëm konsumin tuaj të marrë nga rrjeti i shpërndarjes kurse në këtë mënyrë i zvogëloni ndjeshëm shpenzimet për energji elektrike. Me mirëmbajtjen e rregullt, e cila është e lehtë dhe e thjeshtë, kohëzgjatja e paneleve diellore mund të jetë deri në 25 vjet. Ekzistojnë shumë arsye shtesë përse të vendosni që të instaloni një sistem fotovoltaik. Duke shfrytëzuar diellin si një burim të lirë dhe të pashtershëm të energjisë, objektet tuaja bëhen gjithnjë e më të pavarura dhe vlera e tyre rritet ndjeshëm. Energjia diellore ju mundëson të prodhoni energjinë tuaj të „gjelbër“, e cila mund të përdoret menjëherë. Në këtë mënyrë ju zvogëloni shfrytëzimin e burimeve të parapërtshme të energjisë dhe ndihmoni në mbrojtjen e mjedisit jetësor duke reduktuar emetimet e CO2. Kështu, kompania juaj e përparon imazhin e saj në publik si një kompani me përgjegjësi shoqërore që kujdeset për mjedisin.

## Si të merrni shërbimin e ri?

EVN-ja ju ofron një shërbim të bazuar në njohuri dhe ekspertizë dhe në përputhje me nevojat tuaja specifike do t'ju ofrojë një zgjidhje të personalizuar që do t'ju japë rezultatet më të mira.

### Hapi 1: Dorëzoni kërkesë

Ju mund të dorëzoni kërkesën në Qendrën e Informacionit në Qendrën Tregtare të Qytetit në Shkup, duke telefonuar në 089 089 089 ose duke dërguar një e-mail në gosolar@evn.mk. Në kërkesë, vendosni karakteristikat themelore të objektit / lokacionit (vendndodhjen e saktë të vendit / objektit), sipërfaqen e çatisë / lokacionit në dispozicion, numrin e shfrytëzuesit të energjisë elektrike që korrespondon me pronësinë e ndërtesës / parcelës.

### Hapi 2: Krijojmë zgjidhje


Ekipi ynë i ekspertëve do t'ju japë mbështetje dhe konsultime duke:

- përcaktuar vendndodhjen dhe pozicionin më të përshtatshëm për vendosjen e paneleve;
- ju ndihmuar në përzgjedhjen e modelit më të përshtatshëm të paneleve;
- bërë një llogaritje të përafërt për prodhimin e pritshëm të energjisë elektrike.

### Hapi 3: Marrëveshja dhe instalimi

Me lidhjen e marrëveshjes me EVN-në ju do të fitoni:

- sistem fotovoltaik të instaluar në bazë të parimit “çelës në dorë”.



**AJDOVAN ADEMOSKI, PRESIDENT I ODËS EKONOMIKE TË MAQEDONI-TURQI (MATTO)**

# Në EVN Maqedoni Elektrofurnizimi kemi një partner dhe mbështetje të sigurt në punën e përditshme

→ **EVN Zhurnal:** Si pronar i shumë kompanive që tashmë furnizohen me energji elektrike në tregun e hapur dhe president i Odës Ekonomike Maqedoni-Turqi (MATTO), sipas Jush cilat janë fitimet nga ky treg?

**Z. Ajdovan Ademoski:** Furnizimi me energji elektrike në tregun e hapur është mundësi që çdo kompani të përzgjedhë furnizuesin i cili do të plotësojë nevojat dhe kërkesat e saj, si edhe specifika të caktuara karakteristike për çdo kompani më vete. Tregu i hapur mundëson bashkëpunim me furnizues të sigurt dhe stabil me energji elektrike sipas përzgjedhjes personale dhe në përputhje me konsumin të sigurohet edhe çmim i volitshëm. Kjo është shumë e rëndësishme edhe për ne si kompani, e cila edhe pse nuk është në sektorin industrial, megjithatë ka shpenzime të theksuara për energjinë elektrike.

→ **EVN Zhurnal:** Çfarë do të thotë për Ju bashkëpunimi me një furnizues të sigurt me energji elektrike siç është EVN Maqedoni Elektrofurnizimi?

**Z. Ajdovan Ademoski:** Për biznesin tonë përveç zvogëlimit dhe planifikimit të shpenzimeve, është e domosdoshme edhe cilësia e shërbimit, por para së gjithash siguria në furnizimin me energji elektrike. Për ne bashkëpunimi me EVN Maqedoni Elektrofurnizimi nënkupton pikërisht këtë, partner dhe mbështetje të sigurt në punën e përditshme.

→ **EVN Zhurnal:** Një nga lajmet më aktuale të biznesit në këtë periudhë është hapja e paralajmëruar e hotelit nga zinxhiri i



Për biznesin tonë përveç zvogëlimit dhe planifikimit të shpenzimeve, është e domosdoshme edhe cilësia e shërbimit, por para së gjithash siguria në furnizimin me energji elektrike.

famshëm botëror „Hilton“. Si investitor dhe përfaqësues i franshizës së këtij hoteli, mund të na shpjegoni më hollësisht se çfarë ofron ky hotel

**Z. Ajdovan Ademoski:** Hoteli ofron shërbime gjatë qëndrimit të përkohshëm dhe shërbime katering me një mundësi

për shfrytëzim të 170 dhomave, si dhe dy restoranteve dhe pesë sallave për konferenca, kategori të lartë dhe shërbim adekuat cilësor. Hoteli do të ofrojë shërbime për klientët nga të gjithë sektorët, që është nga turistët e rregullt deri në organizimin dhe mbulimin e ngjarjeve politike, takimeve

presidenciale, kongrese, konferenca dhe evenimente të ngjashme. Objekti përfshin, gjithashtu, një qendër spa që do të sigurojë kënaqësi dhe kohë cilësore për vizitorët. Objekti është paraparë gjithashtu për organizimin e të gjitha llojeve të festimeve dhe evenimenteve familjare. Grupi i synuar i përdoruesve nuk janë vetëm të huajt, por edhe vizitorët vendas, pra përdoruesit e shërbimeve tona.

→ **EVN Zhurnal:** Cilat masa janë paraparë për arritjen e efikasitetit energjetik në Hotelin “Hilton”?

**Z. Ajdovan Ademoski:** Efikasitetin energjetik hoteli e arrin me përzgjedhjen e kujdeshme të materialeve ndërtimore, të cilat për shkak të vetive që i posedojnë sigurojnë efikasitet energjetik në afat të gjatë. Bëhet fjalë për materiale nga prodhuesit e njohur botërorë që posedojnë certifikata për efikasitet energjetik.

→ **EVN Zhurnal:** Cilat janë planet Tuaja për investime në Maqedoni në një të ardhme të afërme?

**Z. Ajdovan Ademoski:** Duke pasur parasysh investimin momental si edhe shpenzimet që do t'i kemi në periudhën e ardhshme, kompania jonë do të fokusohet në etablimin dhe menaxhimin e objektit të ri, kurse në një të ardhme të afërme plani ynë është hoteli “Stoun Brixh”, i cili është gjithashtu në pronësi të holdingut tonë, ta përfshijmë nën franshizën e “Hilton Worldwide”.





## “Dita e Tesllës” – Përmbajtje të reja në Qendrën ekspozuese në “Matkë”

Në qendrën ekspozuese për energjinë elektrike “Matka”, u mbajt për herë të parë „Dita e Tesllës”, me të cilën shënohet 162 vjet i lindjes së shkencëtarit, novatorit dhe futuristit Nikola Teslla.

Më shumë se 150 fëmijë patën mundësinë unike për të qenë pjesë e këtij aktiviteti edukativ të organizuar nga EVN Maqedonia falas.

Në suazat e “Ditës së Tesllës” u mbajtën disa punëtori të ndryshme të frymëzuara nga jeta dhe puna e shkencëtarit. Në pjesën e parë të evenimentit, Teatri i Fëmijëve dhe të Rinjve në Shkup luajti shfaqjen “Giga Mega përralla”. Mandej, fëmijët

patën mundësinë të marrin pjesë në punëtorinë kreative, ku frymëzimi kryesor ishte fëmijëria e Nikolla Tesllës. Punëtorja për piktorët e rinj i punoi arritjet e tij më të mëdha dhe u mbajt një leksion mbi temën “Fuqia e elektricitetit”. Vëmendje të veçantë të audiencës tërhoqi shfaqja e filmit dokumentar “Teslla përdor fuqinë e Ujëvarave të Niagarës”.

Në pjesën e dytë të evenimentit, pjesëmarrësit patën mundësi të kryejnë eksperimente bazuar në shpikjet më të rëndësishme të Tesllës: transmetimi i radios, transmetimi me valë të energjisë dhe frekuenca të larta, ndërsa më të rinjtë krijuan makete me lego kuba, të frymëzuara nga veprat e shkencëtarit të madh.

